

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Kroacia miraton blerjen e 18 sistemeve raketore Chunmoo nga Koreja e Jugut                                                                                                                                                                              |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/rajoni/kroacia-miraton-blerjen-e-18-sistemeve-raketore-chunmo-o-nga-koreja-e-jugu-i584162">https://www.gazetatema.net/rajoni/kroacia-miraton-blerjen-e-18-sistemeve-raketore-chunmo-o-nga-koreja-e-jugu-i584162</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | redirected                                                                                                                                                                                                                                              |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                          |
|-----------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 5 shtator 2026, 16:17:26 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 5 shtator 2026, 17:45:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 3903d41ec6c32bce83f5842eeb04098c214de3e7163f1b55455bbdec0b5a5a11 |
| TEKSTI     | d303acd6fde5fb3534e98c2b76cd536efe08152f4da060056a69c8359abb72ac |
| PAMJA      | 55e7f0d845a75cf306e48abcc2fa52d2078ddaeb2715bb40a460a4490934e0eb |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 6aec20f726ff57ce1d9d7ebb97a241927d0e856fb089ebcd7884ee7144744871   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | 82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326   |
| ANKORUAR      | Polygon PoS · bllok 46991200                                       |
| TRANSAKSIONI  | 0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3 |
| IPFS          | QmcQ2vpHEy67KT56kkLrEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz                     |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6aec20f726ff57ce1d9d7ebb97a241927d0e856fb089ebcd7884ee7144744871>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)




le "U isheh ne tualet", policia jep detaje nga arrestimi i Jozefin MarkutBarcelona zgjedh pese kapitenet per sezonin e ri, surpriza eshte Lamine YamalMuni ve ne veprim "Pla fundit

## Kroacia miraton blerjen e 18 sistemeve rakitore Chunmoo nga Koreja e Jugut



5 Shtator 2026, 19:45Rajoni TEMA



Qeveria kroate miratoi të premten blerjen e 18 sistemeve rakitore koreanojugore K239 Chunmoo, si pjesë e një pakete investimesh për modernizimin dhe pajisjen e ushtrisë.

Blerja, me vlerë 544,1 milionë euro, përfshin sistemet lëshuese, municionet rakitore dhe pajisjet shoqëruese. Dorëzimet do të realizohen nga viti 2026 deri në vitin 2029.

Sistemet Chunmoo do të zëvendësojnë sistemet e vjetruara SVLR Vulkan dhe SVLR GRAD BM-21, duke i mundësuar ushtrisë kryerjen e goditjeve të sakta ndaj objektivave në distanca përtej rrezes së artilerisë konvencionale me tyta dhe raketa.

Kryeministri Andrej Plenković tha se ky është investimi më i rëndësishëm për ushtrinë që nga viti 1995.

"Pas Rafale, ky është një nga investimet më të mëdha dhe më të rëndësishme në modernizimin e Forcave të Armatosura Kroate që nga përfundimi i Luftës së Atdheut. Për herë të parë, po fitojmë aftësinë për të goditur shpejt dhe me saktësi objektiva në distanca shumë të gjata", tha ai.

Sipas qeverisë, sistemi Chunmoo mund të përdorë dy lloje të ndryshme raketash të kalibrave të ndryshëm në të njëjtin sistem lëshues.

Procedura e prokurimit u zhvillua me kompaninë koreanojugore Hanwha Aerospace dhe kompaninë polake WB Electronics.

Hanwha Aerospace do të furnizojë sistemet lëshuese, municionet rakitore dhe pajisjet shoqëruese. Ndërkaq, WB Electronics do të sigurojë sistemin e komandës dhe kontrollit.

"Kroacia po investon në kapacitetet e saj mbrojtëse, jo për të kërcënuar askënd, por për të parandaluar çdo kërcënim, për të garantuar sigurinë e qytetarëve, territorit dhe interesave kombëtare kroate dhe, në këtë mënyrë, për të kontribuar në sigurinë dhe mbrojtjen kolektive të Evropës", tha Plenković.

Qeveria miratoi gjithashtu pajisje shtesë për avionët luftarakë shumërolësh Rafale të Kroacisë, me vlerë 112.224 milionë euro, përfshirë TVSH-në.

Pajisjet do t'i përmirësojnë avionët nga standardi F3R në F4 dhe përfshijnë detektorë raketash, si dhe sisteme për zbulimin, identifikimin dhe gjurmimin e

objektivave në ajër, njoftoi Ministria e Mbrojtjes.

Qeveria miratoi gjithashtu përmirësimin e sistemit të komunikimit luftarak të Forcave Ajrore, me një kosto prej 41,1 milionë eurosh, ndërsa puna është planifikuar të zhvillohet nga viti 2026 deri në vitin 2030.

 Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

[A është vënë në pikëpyetje turneu rajonal i shefes së KE-së për shkak të Serbisë?](#)

17:45 Rajoni

Bedri Hamza: PDK do të veprojë që ligjshmëria të rikthehet në Kosovë

15:55 Rajoni / 1 koment

Pasaporta para njeriut

11:15 Rajoni

## Kosova pjesë e EFTA-s, marrëveshja e Tregtisë së Lirë hyn në fuqi më 1 tetor të këtij viti

07:42 Rajoni / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.